



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK KAVAJË

VENDIM

Nr. 12 Datë 26 / 03 / 2025

Për Dhënien e titullit QYTETAR NDERI, për mësuesit e shquar SHKËLZEN dhe DHURATA KARKINI me motivacionin:

“Për kontributin e çmuar dhënë në shërbim të edukimit të brezave të nxënësve. Konkretizimit në përditshmëri të një stili shembullor komunikimi në procesin mësimor dhe edukativ në shkollë e jashtë saj. Me profesionalizëm të lartë ka arritur të fitojë admirimin e të gjithëve duke ruajtur e përsosur me dinjitet të lartë misionin e lartësisë të detyrës së mësuesit në çdo aspekt”.

Në mbështetje të nenit 54 gërma “m” të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në Ligjin 8480, date 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, në Ligjin Nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave për dhënien e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin e Procedurave Administrative, në mbledhjen e radhës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Dhënien e titullit **QYTETAR NDERI, për mësuesit e shquar SHKËLZEN KARKINI dhe DHURATA KARKINI.**
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Trashigimisë Kulturore, Turizmit dhe Sporteve me motivacionin:
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015,

KRYETAR

RUDIN HYLVIU

Sekretari i Këshillit Bashkiak

MERI BITURKU



Miratuar me vota 23

Vota Pro 23

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 27/03/2025